

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

“KRITERET PËR NDARJEN E SHKELJEVE ME PASOJA TË LEHTA
APO ME PASOJA TË RËNDA DHE SANKSIONET FINANCIARE, NË
FONDIN PYJOR KOMBËTAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i kritereve për ndarjen e pasojave të lehta dhe të rënda dhe sanksionet financiare për kundravajtjet në Fondin Pyjor Kombëtar, të cilat kryhen në kundërshtim me kuadrin ligjor për pyjet dhe biodiversitetin. Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektvendimi janë mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, menaxhimi i qëndrueshëm i habitateve dhe llojeve të florës dhe faunës së egër, dhe të ekosistemeve pyjore duke sjellë edhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të pyjeve që mundëson një jetë më të mirë për shoqërinë sot dhe brezat e së ardhmes.

Ligi nr. 57/2020 “Për pyjet” në pikën 10, të nenit 36, autorizon Këshillin e Ministrave, që me propozim të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, të përcaktojë kriteret për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda dhe sanksionet financiare për ndërhyrjet e paligjshme apo kalimin e kompetencave sipa veprimtarive të miratuara në Fondin Pyjor Kombëtar.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi që paraqesim për shqyrtim dhe miratim është pjesë e matricës analitike të projektakteve për vitin 2022 (miratuar me VKM nr.850, datë Relacion shpjegues për projektvendimin: “Kriteret për ushtrimin, miratimin dhe monitorimin e veprimtarive kërkimore-shkencore në Fondin Pyjor Kombëtar”

29.12.2021, "Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analistik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë viti 2022"). Gjithashtu projektvendimi është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave për fushën e veprimtarisë që mbulon Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Miratimi i këtij projektvendimi kontribuojnë gjithashtu në zbatimin e masave të parashikuara në Dokumentin e Politikave për Pyjet në Shqipëri.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi synon të miratojë kriteret për ndarjen e pasojave të lehta dhe të rënda dhe sanksionet financiare për kundravajtjet në Fondin Pyor Kombëtar. Ky akt jep kornizën e përshtatshme lidhur me kriteret dhe mënyrën e vlerësimit të shkeljeve (kundravajtjeve) në fondin pyor. Kornizë që përmban rëndësinë e ekosistemeve natyrore pyjore, zonave të veçanta me status mbrojtës, drurëve pyjorë me status të veçantë, grumbujve pyjorë, mënyrat e ndërrhyrjeve, shkeljet që shkaktojnë dëme të mëdha deri në të pakthyeshme, vendosja e vlerës së dëmit dhe vendosja e sanksioneve financiare për të mundësuar kthimin e sipërfaqeve pyjore të dëmtura në gjendjen e tyre normale sa më natyrore. Projektvendimi që paraqesim për shqyrtim do të kontribuojë në rregullimin dhe vendosjen e masave shtrënguese dhe sanksioneve financiare në mënyrë të tillë që të mundësohet mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me kuadrin ligjor Kombëtar të Sektorit Pyor dhe hartohet në zbatim të pikës 10, neni 36, të Ligjit 57/2020, datë 30.4.2020, "Për pyjet".

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Relacion shpjegues për projektvendimin: "Kriteret për ushtrimin, miratimin dhe monitorimin e veprimtarive kërkimore-shkencore në Fondin Pyor Kombëtar"

Projektvendimi nuk synon transpozimin e *acquis communautaire*.

VII. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi në përbajtje të tij konsiston në përcaktimin e kritereve për ndarjen e pasojave të lehta dhe të rënda dhe sanksionet financiare për kundravajtjet në Fondin Pyjor, ka të përcaktuar 5 pikat:

Në pikën 1, theksohet se kriteret për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda në Fondin Pyjor Kombëtar, bëhen sipas përcaktimeve në këtë vendim. Për vodosjen e këtyre kritereve dhe sanksionet financiare janë marrë për bazë gjykimi dhc vlerësimi i aktiviteteve/ndërhyrjeve që shkaktojnë dëme në Fondin Pyjor Kombëtar dhe pjesëve përbërëse të tij.

Në pikën 2, janë përcaktuar kriteret për vlerësimin e shkeljeve me pasoja të rënda në varësi të dëmit të shkaktuar në Fondin Pyjor Kombëtar. Kjo pikë përmban 21 nënpika (shkronja), në të cilat si kritere janë përdorur normat për të vlerësuar një ngjarje që bie ndesh me ligjin në Fondin Pyjor Kombetar dhe/ose për të përcaktuar diçka që e dëmton këtë fond me pasoja të lehta apo të rënda e deri në të pakthyeshme.

Nënpikat a; b; c; d dhe e, përmbajnë kriteret e vlerësimit të shkeljeve me pasoja të rënda në ekosistemet dhe zonat e mbrojtura apo me rëndësi të veçantë.

Nënpika f, përmban kriteret e vlerësimit të shkeljeve me pasoja të rënda në rastet e importit, tregimit dhe mbjelljes së materialit mbjellës bimor të sëmurë/infektuar dhe të pashoqëruar me certifikatën e origjinës dhe fitosanitare.

Nënpikat g; h; i; j; k; l; m; n; o; p dhe q, përmban kriteret e vlerësimit të shkeljeve me pasoja të rënda në rastet e kullotjes në pyllëzimet e reja, dëmtimin e filizërisë, dëmtimin e infrastrukturës, tjetërsimin e sipërfaqeve pyjore, prerjet në kufirin e sipërm të vegjetacionit, prerjet në masë, falsifikimin e çekiç-damkës e markuesve të lëndës drusore, djegien e sipërfaqeve pyjore dhe krasitjen mbi 30% të nëngastrës dhe nxjerrejen e lëndëve të tjera pyjore jo drusore.

Nënpika r, përcakton si shkelje të rëndë transportin dhe eksportin e lëndës drusore dhe bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore, pa dokumentat shoqëruese të tyre të lëshuara nga organet të ngarkuara me ligj.

Relacion shpjegues për projektvendimin: "Kriteret për ushtrimin, miratimin dhe monitorimin e veprimitarive kërkimore-shkencore në Fondin Pyjor Kombëtar"

Nënpika s, përcakton si shkelje të rëndë përsëritjen e shkeljeve administrative. Nënpika t, përcakton si shkelje të rëndë mos realizimin e detyrimit të pyllëzimeve si detyrim i subjekteve që ushtrojnë aktivitet në Fondin Pyjor Kombëtar.

Nënpika u, përcakton si shkelje të rëndë pengimin e strukturave qendrore, vendore përgjegjëse për pyjet apo strukturave inspektuese e kontrolluese në kryerjen e detyrave të përektuara nga ligji.

Pika 3, përcakton se shkeljet që nuk përfshijnë kriteret e përektuara në pikën 2, të këtij vendimi, konsiderohen shkelje me pasoja të lehta.

Pika 4, përcakton sanksionet finaciare së një dëmi konkret të shkaktuar në fondin pyjor kombëtar, ku mbahen parasysh treguesit si, sipërfaqjae dëmtuar sattusi i saj, shkalla e dëmit, mënyra e shkaktimit të dëmit, mënyra e llogaritjes së dëmit dhe rehabilitimi i tij.

Pika 5, ngarkon institucionet përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen bashkitë, organet kontrolluese dhe inspektuese të nhgarkuara me ligj, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

Projektvendimi është dërguar për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme dhe Agjencisë së Vetëqeverisjes Vendore.


VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga strukturat përgjegjëse për pyjet në bashkëpunim me sektorin e legjislacionit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Relacion shpjegues për projektvendimin: "Kriteret për ushtrimin, miratimin dhe monitorimin e veprimtarive kërkimore-shkencore në Fondin Pyjor Kombëtar"

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, pasi mbikëqyrja e gjithë veprimtarisë do të kryhet nga strukturat për pyjet në bashki dhe strukturat e tjera përgjegjëse për pyjet dhe si rrjedhim kjo kosto është pjesë e shpenzimeve të pagave të punonjësve.

MINISTRI

Mirela KUMBARO FURXHI